



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I ARTEVE

Rr. Agim Ramadani; P.N. 10000 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel.: +381 38 220 294; web-mail: www.arte.uni-pr.edu

Curriculum- Syllabus	
Viti Akademik 2024/ 2025	
Të dhënat bazike të lendes	
Njësia Akadematike:	Fakulteti i Arteve/ Departamenti i Arteve të Bukura/ Programi i Arteve Vizuale/ Profili: Skulpturë
Titulli i lëndës:	Skulpturë II
Niveli:	Bachelor
Statusi:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Vitit II
Numri i orëve:	6 (H) + 0 (U)
ECTS:	24
Ora / lokacioni:	E hënë & E martë / 09:00 – 11:15h
Mësimdhënësi:	MR. Art. Adem Rusinovci- Prof
Kontakti:	E- mail: adem.rusinovci@uni-pr.edu Mob: + 383 (0) 44 151 113
Përshkrimi i lëndës	
	Lënda "Skulpturë II" është një vazhdim i hulumtimit të skulpturës me një fokus të veçantë në modelimin e portreteve dhe figurave trupore. Ajo kombinon praktikën tradicionale dhe teknikat moderne për të ndërtuar një bazë të qëndrueshme të aftësive teknike, ndërsa inkurajon eksplorimin krijues dhe eksperimentimin artistik. Studentët mësojnë të modelojnë fytyrën dhe trupin njerëzor me një qasje të balancuar midis saktësisë anatomike dhe shprehjes artistike. Pjesë e rëndësishme e lëndës është eksplorimi i artistëve klasikë dhe bashkëkohorë, dokumentimi dhe prezantimi i punimeve, si dhe përgatitja për një ekspozitë përfundimtare.

Qëllimet e lëndës

- Të pajisë studentët me një kuptim të thelluar të strukturës anatomike të fytyrës dhe trupit njerëzor.
- Të zhvillojë aftësi teknike për të punuar me materiale të ndryshme si argjila, gipsi dhe materiale alternative.
- Të nxisë një qasje personale dhe të qëndrueshme artistike përmes praktikës së vazhdueshme dhe eksperimentimit.
- Të zhvillojë aftësinë e analizës kritike dhe të vetë-reflektimit për të interpretuar dhe përmirësuar punën artistike.
- Të prezantojë studentët me ndikimin historik dhe bashkëkohor të artistëve si Michelangelo, Rodin, Antony Gormley, dhe Odise Paskali, duke lidhur teorinë me praktikën.
- Të aftësojë studentët në dokumentimin dhe prezantimin e skulpturave për audienca dhe ekspozita profesionale.
- Të analizohet ndikimi i konteksteve kulturore, institucionale dhe etike në kreativitet.
- Të inkurajohen qasje ndërdisiplinore dhe bashkëpunuese në krijimin artistik.

Rezultatet e të nxënit	<p>Njohuritë</p> <ul style="list-style-type: none"> Njohuri mbi anatomitë e fytyrës dhe trupit dhe rëndësinë e proporcioneve. Njohuri mbi materialet tradicionale dhe eksperimentale në skulpturë. Kuptim i teknikave dhe metodave për krijimin e portreteve dhe figurave trupore. Njohuri mbi artistët kryesorë që kanë ndikuar në zhvillimin e skulpturës (Michelangelo, Rodin, Moore, Gormley, etj.). Kuptim i procesit të patinimit, ngjyrosjes dhe dokumentimit të skulpturave. <p>Shkathtësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> Aftësi për të modeluar portrete dhe figura trupore nga modele të gjalla ose referenca vizuale. Aftësi për të eksperimentuar me materiale si argjila, guri, gipsi dhe patinimi. Përdorimi i veglave dhe teknikave të ndryshme për modelimin dhe përpunimin e materialeve. Zhvillimi i strukturave bazike dhe përpunimi i detajeve për portretet dhe figurat trupore. Dokumentimi dhe prezantimi i punimeve në ekspozita profesionale. <p>Kompetencat</p> <ul style="list-style-type: none"> Aftësi për të ndërtuar një praktikë të qëndrueshme artistike dhe profesionale. Aftësi për të krijuar një qasje personale artistike në trajtimin e portreteve dhe trupave njerëzorë. Zhvillimi i analizës kritike dhe reflektimit mbi punën personale dhe atë të tjerëve. Ndërtimi i lidhjes midis teorisë dhe praktikës përmes studimit të artistëve dhe teknologjive bashkëkohore. Zbatimi i njohurive për krijimin dhe ekspozimin e skulpturave si pjesë e projekteve artistike.
-------------------------------	---

Kontributi në detyrën e studentit (që duhet të përputhet me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Lënda	Ditët/javët	Total
Ligjerata	6	30	180
Ushtrime teorike/ laboratorike	0	0	0
Punë praktike	6	30	180
Konsulta me mësuesin/konsultime	4	10	40

Ushtrime në terren	0	0	0
Kolokium, punim semestral	5	5	25
Detyra shtëpie	5	5	25
Koha e studentëve për studim (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	10	1	10
Koha e studentëve për studim (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	2	10
Projekte, prezantime, etj.	2	10	20
Total			600

Metodologjia e Mësimdhënies:	<p>Semestri dimëror:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në anatomitë e fytyrës dhe përvetësimi i teknikave bazë për modelimin e portreteve. - Ushtrime praktike me argjilë dhe vizatime anatomike. - Studime teorike mbi artistët klasikë dhe bashkëkohorë. - Modelimi i detajeve të fytyrës (sytë, hunda, buzët, etj.) dhe eksperimentimi me sipërfaqe dhe teksturë. - Prezantimi dhe diskutimi i punimeve për portrete. <p>Semestri veror:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në anatomitë trupore dhe ndërtimi i figurave trupore të plota. - Ushtrime praktike për studimin e proporcioneve dhe strukturave trupore. - Eksperimentime me materiale dhe teknika (ngjyrosje, patinim, deformim artistik). - Përdorimi i modeleve të gjalla dhe referencave për modelim realist. - Përgatitja dhe prezantimi i punimeve për figurën trupore në një ekspozitë kolektive. 		

METODAT E VLERËSIMIT:	Sistemi i Vlerësimit për Skulpturë II		
	Vlerësimi është i ndarë në katër faza që përfshijnë vijueshmërinë e studentëve, angazhimin në aktivitete të ndryshme, realizimin e projekteve dhe performancën përfundimtare. Secila fazë përbëhet nga afërsisht 8 njësi mësimore, dhe përqindjet e pikëve rriten progresivisht me zhvillimin e studentëve dhe kompleksitetin e detyrave.		
FAZA 1: KRIJIMI I PORTRETIT (FOKUSI NË DETAJET E FYTYRËS) (20%)			
Komponenti	Përqindja	Pikët	Sqarim
Pjesëmarrja aktive	5%	5 pikë	Angazhimi në ligjërata, prezencë dhe përfshirje aktive në diskutime.
Projekti i parë; Modelimi i portretit 1 - Modele të gjalla dhe referenca - Puna nga modele të gjalla ose fotografi për të përsosur portretin e parë.	10%	10 pikë	Përfshirja në dy fazat e projektit (punimi i portretit 1 dhe 2), si dhe prezantimi i të gjeturave materiale.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	5%	5 pikë	
Totali për Fazën 1	20%	20 pikë	
FAZA 2: MODELIMI I PORTRETIT TË DYTË (20%)			
Komponenti	Përqindja	Pikët	Sqarim
Detyrat e shtëpisë dhe hulumtimet	5%	5 pikë	Zhvillimi i Aftësive dhe Hulumtimeve Artistike
Projekti i dytë: Modelimi i portretit 2 - Modele të gjalla dhe referenca - Puna nga modele të gjalla ose fotografi për të përsosur portretin e parë.	10%	10 pikë	Përfshirja në dy fazat e projektit (punimi i portretit 1 dhe 2), si dhe prezantimi i të gjeturave materiale.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	5%	5 pikë	
Totali për Fazën 2	20%	20 pikë	
FAZA 3: KRIJIMI I FIGURËS TRUPORE (FOKUSI NË TRUPIN E PLOTË) (25%)			
	Përqindja		Sqarim
Pjesëmarrja në vizita dhe debate në klasë	5%	5 pikë	Përfshirja në aktivitetet kulturore

Projekti i tretë: Teknika për shprehjen e lëvizjes në skulpturë + fillimi i punimit të figures trupore	10%	10 pikë	Realizimi i projektit në varësi të temës së caktuar mbi temat e spjeguar në sillabus.
Kritika dhe reflektimi grupor	5%	5 pikë	Përfshirja në analizën dhe përmirësimin e projekteve personale dhe të bashkëstudentëve.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	5%	5 pikë	
Totali për Fazën 3	25%	25 pikë	

FAZA 4: PËRGATITJA DHE PROJEKTI/VEPRA PËRFUNDIMTARE (35%)

	Përqindja		Sqarim
Pjesëmarrja dhe aktiviteti në klasë gjatë fazës përfundimtare	5%	5 pikë	Kontributi në diskutime mbi temat e zhvilluara në klasë
Projekti përfundimtar: Realizimi i figures së plote njëzore	20%	20 pikë	Realizimi i projektit final me fokus në stilin personal dhe qasjen origjinale, si dhe prezantimi i ekspozimit të saj.
Ekspozita	5%	5 pikë	Organizimi dhe prezantimi i punimeve përfundimtare në ekspozitë, si dhe mbrojtja e temës përmes analizës kritike të veprës personale.
Vijueshmëria dhe aktiviteti në klasë	5%	5 pikë	
Totali për Fazën 4	35%	35 pikë	

SHPËRNDARJA E PIKËVE PËR NOTAT

Pikët < 50	Nota = 5
Pikët ≥ 50 dhe Pikët < 60	Nota = 6
Pikët ≥ 60 dhe Pikët < 70	Nota = 7
Pikët ≥ 70 dhe Pikët < 80	Nota = 8
Pikët ≥ 80 dhe Pikët < 90	Nota = 9
Pikët ≥ 90	Nota = 10

Literatura	
Literatura Bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Michelangelo Buonarroti. The Complete Sculpture of Michelangelo. Harry N. Abrams, 1996.</i> - <i>Rodin, Auguste. Rodin on Art and Artists. Dover Publications, 2001.</i> - <i>Moore, Henry. The Art of Sculpture. Praeger, 1960.</i> - <i>Gormley, Antony. On Sculpture. Thames & Hudson, 2015.</i> - <i>Arnheim, Rudolf. Art and Visual Perception: A Psychology of the Creative Eye. University of California Press, 1974.</i> - <i>Paskali, Odise. Skulptura Shqiptare në Vite. Onufri, 2000.</i> - <i>Reti, Lucio. Techniques of Sculpture. Dover Publications, 1982.</i> - <i>Smith, Kiki. Kiki Smith: A Gathering, 1980-2005. Walker Art Center, 2005.</i>
Literatura Shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Beard, Geoffrey. The Language of Sculpture. Thames & Hudson, 1995.</i> - <i>Focillon, Henri. The Life of Forms in Art. Zone Books, 1989.</i> - <i>Goldsworthy, Andy. Time. Harry N. Abrams, 2000.</i> - <i>Halilaj, Petrit. The Place for My Story. Fondazione Merz, 2020.</i> - <i>Eliasson, Olafur. Studio Olafur Eliasson: The Kitchen. Phaidon, 2016.</i> - <i>Synnott, Anthony. The Body Social: Symbolism, Self and Society. Routledge, 1993.</i> - <i>Bourgeois, Louise. The Fabric Works. Fondazione Vedova, 2010.</i> - <i>Tzonis, Alexander. Classical Architecture: The Poetics of Order. MIT Press, 1986.</i>
Plani i Mësimi të Dizenjuar	
Java e parë:	INTRO; Krijimi i Portretit (Fokusi në detajet e fytyrës)
Java e dytë:	Hyrje në skulpturë dhe materialet - Njohja me historinë dhe teknikën e skulpturës. Materialet: argjila, guri, dhe veglat kryesore.
Java e tretë:	Anatomia e fytyrës – Struktura bazë - Studimi i proporcioneve të fytyrës njerëzore. Ushtrime me vizatime dhe modele 3D.
Java e katërt:	Modelimi i kafkës - Ndërtimi i strukturës bazike të kokës duke u bazuar te anatomi e përgjithshme.
Java e pestë:	Puna me detajet e fytyrës: Syri dhe vetullat - Fokus te anatomi e syrit dhe thellësitë përreth.
Java e gjashtë:	Puna me detajet e fytyrës: Hunda dhe buzët - Shprehja e volumit dhe formave organike.
Java e shtatë:	Puna me detajet e fytyrës: Veshi dhe flokët - Dinamika dhe rrjedhshmëria e detajeve organike.
Java e tetë:	Tekstura e lëkurës dhe forma finale - Puna në sipërfaqe për të arritur një teksturë të natyrshme.
Java e nëntë:	Artistë historikë dhe bashkëkohorë në portretizim - Studim teorik: Michelangelo, Gian Lorenzo Bernini, Auguste Rodin. Artistë bashkëkohorë: Ron Mueck, Kiki Smith.
Java e dhjetë:	Modele të gjalla dhe referenca - Puna nga modele të gjalla ose fotografi për të përsosur portretin e parë.
Java e njëmbëdhjetë:	Finalizimi i portretit të parë - Retushim dhe përfundimi i detajeve.

Java e dymbëdhjetë:	Modelimi i portretit të dytë: Karakter dhe shprehje - Përdorimi i shprehjeve të fytyrës për të shfaqur emocionet.
Java e trembëdhjetë:	Eksperimentimi me materiale - Përdorimi i gipsit dhe eksperimente me argjilë me ngjyra.
Java e katërbëdhjetë:	Portretet shqiptare në histori - Artistët shqiptarë: Odise Paskali, Kristina Koljaka.
Java e pesëmbëdhjetë:	Dokumentimi, prezantimi dhe diskutimi i portreteve - Diskutim kolektiv mbi procesin dhe rezultatet.
Java e gjashtëmbëdhjetë:	NTRO; Krijimi i Figurës Trupore (Fokusi në trupin e plotë)
Java e shtatëmbëdhjetë:	Anatomia e trupit – Struktura bazë - Pjesët kryesore të skeletit dhe muskujve në trupin e njeriut.
Java e tetëmbëdhjetë:	Studimi i proporcioneve trupore - Metoda klasike për të vendosur raportet trupore.
Java e nëntëmbëdhjetë:	Pozicioni dhe balanca - Ndërtimi i strukturës fillestare të një figure në pozicion specifik.
Java e njëzet:	Modelimi i krahëve dhe duarve - Fokus te detajet e gjymtyrëve të sipërme.
Java e njëzet e një:	Modelimi i këmbëve dhe këmbëve të poshtme - Vëmendje e veçantë te këmbët dhe detajet e tyre anatomike.
Java e njëzet e dy:	Krijimi i trungut të trupit - Ndërtimi i shpatullave, kurrizit dhe barkut.
Java e njëzet e tre:	eknika për shprehjen e lëvizjes në skulpturë - Forma dinamike dhe kompozimet që japin ndjenjën e lëvizjes.
Java e njëzet e katër:	Artistë klasikë dhe bashkëkohorë në skulpturë trupore - Studim teorik: Auguste Rodin, Henry Moore. Artistë bashkëkohorë: Antony Gormley, Jaume Plensa.
Java e njëzet e pesë:	Eksperimentimi me trajtat e trupit - Deformimi artistik dhe interpretimi personal.
Java e njëzet e gjashtë:	Modele të gjalla: Punë nga observimi direkt - Sesione praktike me modele të gjalla për figurën trupore.
Java e njëzet e shtatë:	Rëndësia e sipërfaqes dhe teksturës në figurë - Puna në teksturën e trupit për të shtuar dimension.
Java e njëzet e tetë:	Puna me ngjyrat dhe patinimin - Eksperimentime me ngjyrosjen e skulpturës (patinim ose aplikim pigmentesh).
Java e njëzet e nëntë:	Finalizimi i figurës trupore - Përfundimi i detajeve dhe elementeve artistike. Dokumentimi dhe prezantimi i figurës trupore - Përgatitja për ekspozim dhe diskutim kolektiv.
Java e tridhjetë:	Ekspozita dhe vlerësimi përfundimtar - Prezantimi i portreteve dhe figurës trupore si një seri punimesh.

Politikat akademike dhe rregullat e sjelljes:

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe parimet e integritetit akademik, politikat dhe rregullat e mëposhtme janë përcaktuar për të siguruar një mjedis të drejtë, respektues dhe të orientuar drejt rezultateve të suksesshme akademike.

Respektimi i Orarit dhe Pjesëmarrja në Mësim

- Studentët duhet të respektojnë në mënyrë të rreptë orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve. Mosprezenca e paarsyetuar mund të ndikojë negativisht në vlerësimin përfundimtar.
- Studenti duhet të njoftojë paraprakisht mësimdhënësin për çdo mungesë të arsyeshme, duke paraqitur dokumentacion përkatës.
- Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe diskutime është një pjesë integrale e procesit të nxënies.

Pajisjet dhe Përgatitja e Studentëve

- Studentët duhet të jenë të përgatitur për çdo sesion mësimor, duke sjellë të gjitha mjetet e nevojshme për punë (p.sh., bllokun e skicave, mjete për pikturim, dhe materiale të tjera sipas temave mësimore).
- Mosplotësimi i këtyre kërkesave mund të ndikojë në vlerësimin e tyre në bazë të angazhimit dhe përgjegjësisë.

Sjellja Akademike dhe Etika Profesionale

- Çdo student duhet të tregojë respekt të plotë ndaj mësimdhënësve, kolegëve dhe stafit administrativ. Çdo sjellje e pahijshme, përfshirë fyerjet ose pengesat e qëllimshme gjatë orës mësimore, do të ndëshkohet sipas rregulloreve disiplinore të Universitetit.
- Diskutimet dhe debatet në klasë duhet të jenë konstruktive dhe të bazuara në mirëkuptim dhe respekt reciprok.
- Studentët janë të ndaluar të përvetësojnë punën e tjetrit dhe të paraqesin atë si të tyre. Plagjiatura dhe mashtrimet akademike do të trajtohen sipas masave disiplinore të Statutit.

Ruajtja e Rregullit dhe Qetësisë

- Studentët duhet të sigurojnë që ambienti mësimor të jetë i pastër, i qetë dhe i përshtatshëm për zhvillimin e ligjëratave dhe ushtrimeve.
- Çdo ndotje ose dëmtim i pasurisë së universitetit do të sjellë masa ndëshkimore, përfshirë edhe kompensimin për dëmet.
- Telefonat celularë dhe pajisjet e tjera teknologjike duhet të shkyçen gjatë orëve mësimore, përveç rasteve kur janë të autorizuar nga mësimdhënësi për qëllime mësimore.

Integriteti në Vlerësim dhe Prezantim

- Çdo student duhet të prezantojë punimet e tij/saj të përfunduara me përpikëri dhe në kohë, sipas kërkesave të programit.
- Gjatë provimeve dhe prezantimeve, studentët duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna dhe të shmangin çdo formë mashtrimi.
- Çdo formë plagjiature, kopjimi ose ndihme të paautorizuar gjatë provimeve do të ndëshkohet sipas Statutit.

Obligimet e Studentëve ndaj Procesit të Mësimdhënies

- Studentët janë të obliguar të respektojnë autoritetin akademik të mësimdhënësve dhe të ndjekin udhëzimet e tyre për realizimin e projekteve dhe detyrave mësimore.
- Është e detyrueshme që studentët të mbajnë dokumentacion të vazhdueshëm mbi procesin e tyre krijues (ditar pune), i cili do të përdoret për reflektim dhe vlerësim gjatë dhe në fund të semestrit.

Dispozita për Mosrespektim të Rregullave

- Çdo mosrespektim i rregullave të mësipërme do të rezultojë në masa ndëshkimore të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Prishtinës. Këto masa përfshijnë:
 - Paralajmërimet verbale ose me shkrim.
 - Ulje të pikëve në vlerësim.
 - Përfshirje nga provimi ose kursi, varësisht nga serioziteti i shkeljes.
 - Vendimet për masat disiplinore do të merren në përputhje me Statutin dhe rregulloret përkatëse të universitetit.

Këto rregulla janë në përputhje të plotë me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe janë krijuar për të siguruar një mjedis të drejtë, të sigurt dhe të frytshëm për të gjithë pjesëmarrësit në procesin mësimor.